

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik të me kohë të plotë në Departamentin e Gjeodezisë.

Kandidatët për personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjeodezisë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

KRITRE KUALIFIKUESE

1. Të zotërojnë diplomë të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor +Master i Shkencave) të studimeve në degën “Gjeodezi” në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (UPT) ose në Universitete Analoge të Huaja (diplomat duhet të jenë njohur nga MAS).
2. Të kenë notë mesatare të studimeve Bachelor + Master i Shkencave ose sistemi 5 vjeçar ≥ 8 (më e lartë ose e barabartë me 8).
3. Të zotërojnë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj (Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht).

KRITRE VLERËSUESE

4. Preferohet të kenë tituj shkencore/akademike.
5. Preferohen kandidatët të cilët kanë kryer kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit.
6. Të kenë përvojë pune si personel akademik pranë një Universiteti të njohur zyrtarisht nga MAS.
7. Të tregojë me dokumenta eksperiencën në disiplinën për të cilën konkuron.
8. Preferohen kandidatët të cilët kanë publikime të tjera në formë artikujsh në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit.
9. Preferohen kandidatët të cilët kanë prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

B. 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë në kategorinë “Asistent-lektor” në Departamentin e Inxhinierisë së Mjedisit për lëndët:

- VSM dhe Lejet e Mjedisit
- Trajtimi i Ndotjes nga Energjia
- Bilanci Energjistik dhe Modelimi

Kandidatët për personel akademik me kohë të plotë në kategorinë “Asistent-lektor” pranë Departamentit të Inxhinierisë së Mjedisit në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

KRITERET E PUNËSIMIT

1. Të jetë diplomuar në degën “Inxhinieri Mjedisit”, Master Shkencor “Profili Energjistik” ose sistemi i integruar 5 vjeçar “Profili Energjistik” në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës ose në Universitete të Huaja;
2. Nota mesatare të jetë ≥ 8.0 për të gjitha ciklet e studimit universitar;
3. Aplikantët kandidatët duhet të kenë eksperiencë pune si personel akademik pranë një Universiteti të njohur zyrtarisht nga MAS.
4. Në rastet kur studimet janë kryer në Universitete jashtë vendit, diplomat duhet të jenë njohur nga MAS;
5. Preferohen kandidatët të cilët kanë eksperiencë në mësimdhënie për disiplinat e kërkuara (e dokumentuar me vërtetimet përkatëse nga Institucionet e angazhuara;
6. Rezultatet (notat mesatare) e arritura gjatë cikleve të studimit universitar;
7. Të zotërojnë një gjuhë të huaj, me dëshmi apo certifikatë të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
8. Preferohen kandidatët të cilët kanë kryer kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit;
9. Preferohen kandidatët të cilët kanë angazhime dhe pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
10. Preferohen kandidatët të cilët kanë publikime të tjera në formë artikujsh në revista brenda dhe jashtë vendit.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje e gradës shkencore “Doktor”;

6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **22.09.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.